



RAPORTI VJETOR

2019

Policia e Shtetit

www.asp.gov.al

PËRMBAJTJA

	HYRJE	3
I.	VEPRIMTARIA PËR DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE AKTET NORMATIVE	4
II.	VEPRAT PENALE	4
III.	HETIMET PROAKTIVE	11
IV.	ASETE TË SEKUESTRUARA NGA VEPRIMTARIA KRIMINALE	12
V.	GRUPE KRIMINALE TË GODITURA	12
VI.	OPERACIONE POLICORE	12
VII.	PERSONA NË KËRKIM	13
VIII.	KULTIVIMI I BIMËVE NARKOTIKE	13
IX.	BURIME TË INFORMACIONIT	14
X.	TASK FORCAT SPECIALE QENDRORE DHE VENDORE	14
XI.	RENDI E SIGURIA PUBLIKE	15
XII.	BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	15
XIII.	MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT DHE MIGRACIONIT	15
XIV.	MENAXHIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	17
XV.	PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT KRYESORE PËR VITIN 2020	19

Hyrje

Gjatë vitit 2019, në qendër të vëmendjes të Policisë së Shtetit ka qenë puna për realizimin e prioriteteve dhe objektivave strategjike të përcaktuara në Politikën Prioritare në Fushën e Rendit e të Sigurisë, Prioritetet Vjetore të Ministrisë së Brendshme, Programin Vjetor të Punës të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, si dhe në dokumente të tjera të rëndësishme si në Strategjinë Kombëtare për Integrim dhe Zhvillim, Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit, Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2018 – 2020 dhe në strategjitë e tjera sektoriale.

Referuar analizave të zhvilluara në të gjitha strukturat, rezulton se gjatë kësaj periudhe raportuese janë përmbushur me sukses detyrat institucionale për ruajtjen e rendit publik, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore, rritjen e standardeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit dhe parandalimin e goditjen e krimit ndërkufitar. Gjithashtu, për këtë periudhë është përfituar përvojë edhe në menaxhimin më të mirë të situatave për ruajtjen e rendit e sigurisë publike gjatë procesit zgjedhor 2019, si dhe zhvillimit të aktiviteteve të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Respektimi i lirive e të drejtave të individit, sigurimi i rendit publik, parandalimi i krimit, sidomos mbrojtja e jetës, shëndetit, pronës publike dhe private, por edhe goditja e çdo lloji krimi e veçanërisht atij të organizuar, kanë qenë prioritetet kryesore të punës së Policisë së Shtetit.

Ndërkohë në vëmendje ka qenë edhe vazhdimi i procesit reformues të Policisë së Shtetit, si nëpërmjet hartimit të legjislacionit të ri të nevojshëm, ashtu edhe për reformimin strukturor e funksional të saj, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe eficiencës së punës.

Në këtë kontekst, synimi kryesor ka qenë dhe mbetet përfarimi i standardeve të sigurisë në vend me ato të vendeve të Bashkimit Evropian dhe sundimi i ligjit në të gjithë territorin e vendit, duke punuar në të njëjtën kohë si për realizimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit, ashtu dhe për përafrimin e legjislacionit të vendit me atë të vendeve BE-së.

Kryerja e aktiviteteve dhe marrja e masave efikase në funksion të realizimit të prioriteteve dhe objektivave strategjike të vendosura në Programin Vjetor të Punës së Policia e Shtetit kanë bërë të mundur realizimin e arritjeve në:

1. Përmirësimin dhe thellimin e punës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, terrorizmit e krimeve të rënda;
2. Forcimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore, me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, me shoqërinë civile, në funksion të rritjes së sigurisë në vend;
3. Zhvillimin e bashkëpunimit intensiv me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë INTERPOL, EUROPOL, FRONTEX, SEPCA, SELEC, etj.
4. Parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike nëpërmjet zbatimit të strategjisë dhe implementimit nga strukturat policore, ato të qeverisjes vendore dhe aktorë e faktorë të tjerë;
5. Rritjen e kërkesës për zbatimin e ligjit dhe ngritjen e nivelit të sigurisë publike, garantimin e lirive e të drejtave të njeriut, nëpërmjet organizimit e funksionimit të shërbimeve të sigurisë për kontrollin e territorit.
6. Rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve dhe besimin e publikut tek policia, reduktimin e krimit të rrugës dhe dhunës në familje, ruajtjen e rendit gjatë periudhës zgjedhore, si dhe parandalimin e aksidenteve rrugore;
7. Rritjen e standardeve të menaxhimit të kontrollit të kufirit, menaxhimin e flukseve migratore sipas standardeve të BE-së, rritjen e cilësisë së nivelit profesional të punonjësve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për migracionin dhe kufirin, si dhe zhvillimin e operacioneve policore të përbashkëta në kufirin Shqipëri - Greqi me shtetet anëtare të BE-së;

I. VEPRIMTARIA PËR DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE AKTET NORMATIVE

Gjatë vitit 2019 strukturat e Policisë së Shtetit janë angazhuar për përgatitjen e disa strategjive dhe planeve të veprimit, akteve normative, marrëveshjeve dhe procedurave.

U miratua Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019-2022 si dhe Plani i Veprimit 2019-2020, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013-2020.

U miratuan projektligji „Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë “Mbi ngritjen dhe funksionimin e një qendre kontakti të përbashkët për bashkëpunim policor dhe doganor” si dhe projektligji "Për Ratifikimin e Konventës së Gjenevës të vitit 1929 Për Shtypjen e Falsifikimit të Monedhës" Gjithashtu u miratuan dy projektvendimet „Për miratimin e Planit Kombëtar për Migracionin“ dhe „Për organizimin, funksionimin dhe fushën e veprimit të policimit vullnetar“

U nënshkruan 5 marrëveshje dhe 4 memorandume si më poshtë:

- Ligji Nr. 6/2019 “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarrura nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.
- Marrëveshje bashkëpunimi mes Policisë së Shtetit dhe një njësie partnere në një vend të BE-së në fushën e mbrojtjes së dëshmitareve.
- Marrëveshje bashkëpunimi mes Policisë së Shtetit dhe një njësie partnere në një vend të BE-së në fushën e mbrojtjes së dëshmitareve.
- Marrëveshje bashkëpunimi për mbështetje logjistike ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Republikës së Kosovës, e ndryshuar më 20.6.2019.
- Marrëveshje bashkëpunimi mes Policisë së Shtetit dhe një njësie partnere në një vend të BE-së në fushën e mbrojtjes së dëshmitareve.
- Memorandumi i bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe Policisë së Kosovës, për patrullimet e përbashkëta gjatë sezonit turistik 2019;
- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Përfaqësisë së OSBE-së në Shqipëri, për zbatimin e analizës së sistemit për bashkërendim, koordinim, bashkëpunim dhe komunikim midis Policisë Gjyqësore dhe Prokurorisë në Procedimet Penale.
- Memorandumi i Bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe Doganave e Tatimeve në Mbretërinë e Bashkuar “Për bashkëpunimin në luftën kundër krimit ekonomik financiar”.
- Memorandumi i Mirëkuptimit mes MB të Republikës Çeke dhe MB të Republikës së Shqipërisë “Për dhurimin e pajisjeve për autoritetet ligj-zbatuese në luftën kundër krimit kibernetik”.

II. VEPRAT PENALE NË TOTAL

Gjatë vitit 2019 janë evidentuar gjithsej 35210 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar autorët për 30249 ose **85.9** % e tyre. Krahasuar me vitin 2018 evidentohen **742** vepra penale më shumë ose **2.1**% më shumë.


Veprat penale sipas tendencave evidentohen si më poshtë:

a) Vepra penale kundër personit.

Janë evidentuar gjithsej **2906** vepra penale, nga të cilat janë zbuluar **2737**, ose **94.2%** tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar 245 vepra penale më pak ose 7.8% më pak.

Krime kundër jetës janë evidentuar **153**, nga të cilat janë zbuluar **127** ose **83%** e tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar 15 vepra penale më pak ose 8.9% vepra penale më pak.

Janë evidentuar **58 raste** vrasje, zbuluar **44** ose **75.9%** e tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar 7 raste më tepër ose 13.7% më tepër.



Objektiva në Programin Vjetor të Policisë së Shtetit kanë qenë:

- Ulja e numrit të krimit të vrasjes me **12%** deri në vitin 2020 (referencë vitit 2014). **Realizuar: 134%** (58 vrasje në 2019).
- Ulja e numri të vrasjeve dhe vrasjeve të mbetura në tentativë me motive gjakmarrje me **45%** deri në vitin 2020 (referencë vitit 2014). Gjatë vitit 2019 **nuk** janë evidentuar vrasje apo tentativë për vrasje për gjakmarrje.
- Rritja e fuqisë zbuluese të krimit të vrasjes me **10%** deri në vitin 2020 (referencë vitit 2014). **Realizuar: 93.4%** (zbulueshmëria **75.9%** gjatë vitit 2019).

Vepra penale krime seksuale evidentuar **155**, zbuluar **142** ose **91.6%** e tyre. Krahasuar me vitin 2018 janë evidentuar 45 vepra penale më shumë ose 41% më shumë.

b) Krimet ndaj pasurisë:

Gjatë vitit 2019 janë evidentuar gjithsej **6689 vepra penale kundër pasurisë**, nga të cilat janë zbuluar **3701**, ose **55.3 %** tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar 549 vepra më pak ose 7.6% më pak.

Evidentuar **12 vepra penale të vjedhjes së bankave**, zbuluar **5** vepra penale ose **41.7%** e tyre. Krahasuar me vitin 2018 janë evidentuar 5 raste ose 71% më shumë.

Vjedhje me pasojë vdekjen **nuk** është evidentuar asnjë rast. Krahasuar me vitin 2018 janë evidentuar 3 raste më pak.

Evidentuar **13 vepra penale të vjedhjes me armë**, zbuluar 9 vepra penale ose 69.2% e tyre. Krahasuar me vitin 2018 janë evidentuar 9 raste ose 40% më pak.

Objektiva në Programin Vjetor të Policisë së Shtetit ka qenë:

- Ulja e numrit të vjedhjeve me armë me **11 %** deri në vitin 2020 (referencë vitit 2014). **Realizuar: 167%** (13 vjedhje me armë gjatë vitit 2019).
- Rritje e fuqisë zbuluese të veprave penale të vjedhjeve me armë me 1.5 % (referencë viti 2018). **Realizuar: 105.6%** (zbulimi 69.2 % gjatë vitit 2019)

Po kështu janë evidentuar **56 vepra penale të shkatërrimit të pronës me eksploziv**, zbuluar 8 vepra penale ose 14.3% e tyre. Krahasuar me vitin 2018 janë evidentuar 4 vepra penale ose 6.7% më pak.

Objektivi në Programin Vjetor ka qenë:

- Rritje e fuqisë zbuluese të veprave penale të shkatërrimit të pronës me eksploziv me 1.5 % (referencë viti 2018). **Realizuar: 72.2%** (zbulimi 14.3% - viti 2019).




c) Vepra penale në fushën e korrupsionit

Gjatë vitit 2019 janë evidentuar gjithsej **1286 vepra penale**, nga të cilat janë zbuluar **1069, ose 83.1 %** tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar 307 më shumë ose 31.3 % vepra penale më shumë.


Objektivi në Programin Vjetor ka qenë:

- Rritja me 2.5 % e numrit të referimeve (referencë viti 2018). **Realizuar: 128.2%**.



d) Vepra penale në fushën ekonomiko - financiare

Janë evidentuar gjithsej **33322 vepra penale**, nga të cilat janë zbuluar **3044, ose 94.4 %** tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar 3 vepra penale **më pak**.




e) Vepra penale në fushën e pastrimit të parave

Janë evidentuar gjithsej **434** vepra penale, nga të cilat janë zbuluar **391, ose 90 %** tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar **19 më shumë ose 4.6 %** vepra penale më shumë.


Objektiva në Programin Vjetor kanë qenë:

- Rritja me 5% e numrit të referimeve të rasteve hetimit të produkteve të veprës penale, (neni 287 - referencë viti 2018). **Realizuar:** 108.6% (366 referime për nenin 287 K.P. - viti 2019)
- Rritja me 5% e hetimeve proaktive për pastrim të produkteve të veprës penale (reference viti 2018). **Realizuar:** 170.7% (239 hetime proaktive viti 2019).



f) Akte terroriste

Gjatë vitit 2019 janë evidentuar gjithsej **33** vepra penale, nga të cilat janë zbuluar **31 ose 93.9%** tyre. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar: 8 vepra penale më shumë ose **32%** vepra penale më shumë.




g) Vepra penale në fushën e krimeve kompjuterike

Janë evidentuar gjithsej **177 vepra penale**, nga të cilat janë zbuluar **63, ose 35.6%** tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar **12 më pak** ose 6.3 % vepra penale më pak.


Objektivi në Programin Vjetor ka qenë:

- Rritja me 3% e numrit i veprave penale të evidentuara për krimet kompjuterike (referencë viti 2018). **Realizuar: 90.7%.**




h) Vepra penale në fushën e narkotikëve

Janë evidentuar gjithsej **2069 vepra penale**, nga të cilat janë zbuluar **1813, ose 87.6%** e tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar **97 më pak** ose **4.9 %** vepra penale më pak.



i) Vepra penale në fushën e trafikeve të paligjshme


Evidentuar gjithsej **1674 vepra penale**, nga të cilat janë zbuluar **1631**, ose **97.4%** e tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar **209 më shumë** ose **14.2%** vepra penale më shumë.



j) Vepra penale të tjera (armëmbajtje pa leje, ndërtime të paligjshme, vepra penale kundër punonjësve të policisë dhe autoriteteve të shtetit).

Janë evidentuar gjithsej **9574** vepra të tjera penale, nga të cilat janë zbuluar **9046**, ose **94.5 %** e tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar **1001** më shumë ose **11.6%** vepra penale më shumë.

Janë evidentuar **4611** vepra penale për armëmbajtje pa leje, ndërtime të paligjshme, vepra penale kundër punonjësve të policisë dhe autoriteteve të shtetit janë zbuluar **4352** ose **94.3%** e tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar **782** vepra penale ose **20.4 %** vepra penale më shumë.




k) Vepra penale ndaj dhunës në familje

Gjatë 2019 janë evidentuar gjithsej **1341** raste të dhunës në familje dhe janë zbuluar **100%** e tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar **33 më pak ose 2.4%** vepra penale më pak.

Objektivi në Programin Vjetor:

- **Rritje me 3%** të numrit të procedimeve penale për dhunë në familje në krahasim me 2018. Realizuar: **94.6%** Megjithëse shifrat mbeten të larta, çka tregon nevojën për intensifikim të mëtejshëm të masave për parandalimin e vrasjeve dhe dhunës në familje, njëherazi rritja e numrit të procedimeve tregon dhe rritje të denoncimit të rasteve, në saj dhe të rritjes së ndërgjegjësimit dhe besimit tek forcat e Policisë së Shtetit.




D) Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor

Gjatë vitit 2019 numri i aksidenteve shënoi një rënie krahasuar me një vit më parë.

Janë evidentuar gjithsej **4310** vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 4233, ose **98.2%** e tyre. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar: 124 vepra penale më pak ose 2.9% vepra penale më pak.

- Objektivi në Programin Vjetor: 1-1.5%: Realizuar: 1 herë më shumë. Megjithatë shqetësim mbeten rastet e vdekjeve në rrugë, të lidhura veçanërisht me tejkalimin e normave të shpejtësisë, parametrat e infrastrukturës rrugore, përdorimin e alkoolit si dhe të celularit.



m) Vepra penale të kryera nga Grup i Strukturuar Kriminal

Evidentuar gjithsej **11 vepra penale**, nga të cilat janë zbuluar 6, ose 54.5% tyre. Në krahasim me vitin 2018 janë evidentuar 4 më shumë ose 57% vepra penale më shumë.

III. HETIMET PROAKTIVE

Gjatë vitit 2019 rritje të ndjeshme shënuan hetimet proaktive, duke rritur nivelin e parandalimit që në fazat e hershme të krimit. Janë zhvilluar gjithsej 1012 hetime proaktive, prej të cilëve:

- 239** hetime proaktive në fushën e narkotikëve (kultivim, prodhim shitje dhe trafikim), prej të cilave:
 - **162** hetime proaktive në fushën e prodhimit, shitjes dhe trafikimit të narkotikëve. Objektivi vjetor ka qenë rritja me 2% e numrit të hetimeve proaktive (referencë viti 2018). **Realizuar 324%**.
 - **77** hetime proaktive në fushën e kultivimit të cannabisit
- 133** hetime proaktive në fushën e trafikëve të paligjshme. Objektivi vjetor ka qenë rritja me 2% e numrit të hetimeve proaktive (referencë viti 2018). Realizuar 122%.
- 640** hetime proaktive në fushën e krimit ekonomik financiar, prej të cilave:

- **239** hetime proaktive për pastrim të produkteve të veprës (Neni 287 i K.P.). Objektivi vjetor ka qenë rritja me 5% e numrit të hetimeve proaktive (referencë viti 2018). Realizuar 170.7 %.
- **397** hetime proaktive në fushën korrupsionit dhe krimeve në detyrë. Objektivi vjetor ka qenë rritja me 5% e numrit të hetimeve proaktive (referencë viti 2018). Realizuar 104.5%.
- **4** hetime proaktive të tjera

IV. ASETË TË SEKUESTRUARA NGA VEPRIMTARIA KRIMINALE

Gjatë vitit 2019 vëmendje të veçantë iu kushtua thellimit të luftës kundër krimit të organizuar duke synuar rritjen e forcës goditëse ndaj grupeve e rrjeteve kriminale, por dhe pasurive të vëna në mënyrë të paligjshme.

U sekuestruan asetë për pastrim parash (neni 287 i Kodit Penal) në vlerën **39,022,512 Euro**.

- Objektivi për asetë të sekuestruara për pastrim parash (neni 287) i vendosur minimumi 5 milion Euro, u realizua **7 herë më shumë**.

Aseteve të sekuestruara nga veprimtari kriminale (hetime penale dhe pasurore sipas Ligjit Antimafia) u arritën në vlerën **56,100,000 Euro**.

- Objektivi vjetor ka qenë rritje me 20% në krahasim me vitin 2018 sekuestrimi i asetëve nga veprimtaria kriminale (Ligji nr. 10192), i cili është **realizuar 217%**.

Janë kryer 128 hetime pasurore, nga 118 hetime të kryera në vitin 2018.

- Objektivi vjetor ka qenë rritja me 2.5% e numrit të hetimeve pasurore dhe është realizuar me 106 %.

Verifikime pasurore për asetet kriminale 6897 raste,

- Objektivi vjetor ka qenë rritja me **30 %** e verifikimeve pasurore për asetet kriminale deri në vitin 2020 (referencë viti 2014) dhe është realizuar **101.2%**.

V. GRUPE KRIMINALE TË GODITURA

Gjatë vitit 2019 janë goditur **43 grupe kriminale**, prej të cilëve:

- **28** grupe kriminale me aktivitet në fushën e narkotikëve.
Indikatori për vitin: Goditja e jo më pak se **27** grupeve të strukturuar kriminale. Realizuar në masën **85.2%**.
- **8** grupe kriminale me aktivitet në fushën e krimit ekonomik-financiar.
- **6** grupe kriminale me aktivitet në fushën e trafikeve të paligjshme
- **1** grup kriminal me aktivitet në fushën e krimeve ndaj pasurisë.

VI. OPERACIONE POLICORE

Në luftën kundër krimit, narkotikëve, trafikeve të paligjshme, pastrimit të parave, krimit ekonomik etj, rëndësi të veçantë i është kushtuar dhe forcimit e rritjes së bashkëpunimit me strukturat homologe, për shkëmbimin e informacionit me qëllim parandalimin dhe goditjen e krimit. Janë zhvilluar gjithsej **361 operacione policore** në fushën e krimit të organizuar dhe krimeve financiare, prej të cilëve:

- **192** operacione policore në fushën e narkotikëve, prej të cilëve 87 operacione në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe 132 operacione kombëtare).
Objektivi i kryerjes së jo më pak se 30 operacione me partnerët ndërkombëtarë, u realizua 200%.
- **65** operacione policore në fushën e trafikeve të paligjshme, prej të cilëve 23 operacione në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe 42 operacione kombëtare.
- **104** operacione policore në fushën e krimit ekonomik financiar, prej të cilëve 4 operacione në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe 100 operacione kombëtare).
Indikatori: Rritja çdo vit me 2.5% e operacioneve policore në fushën e korrupsionit (referencë viti 2018). Realizuar në masën 49%.

VII. PERSONA NË KËRKIM

Gjatë vitit 2019 aktiviteti i strukturave të Policisë së Shtetit për kapjen e personave të shpallur në kërkim është intensifikuar në bashkëpunim me partnerët e huaj ashtu si dhe me institucionet ligjzbatuese në Shqipëri përmes përsosjes dhe sofistikimit të metodave të kërkimit. Ngritja e kapaciteteve dhe krijimi i strukturave të posaçme si FAST Albania (Fugitive Active Search Team) ka rritur efektivitetin për lokalizimin dhe kapjen e personave me rrezikshmëri të lartë. Gjatë vitit analizues janë shpallur në kërkim **3770** persona, 72 persona ose 2% më shumë se në vitin 2018. Janë kapur **1916 persona ose 2.6 %** persona më shumë se në vitin 2018.

VIII. KULTIVIMI I BIMËVE NARKOTIKE:


Bimë narkotike të kultivuara dhe të asgjësuarra, *gjithsej 90175* ose 151 % më shumë se viti 2018.

Sipas mënyrës së identifikimit.

- 44 % e totalit të bimëve narkotike janë identifikuar me informacion policor.
- 21 % e totalit të bimëve narkotike janë identifikuar nga kontrolli i territorit.
- 35 % e totalit të bimëve narkotike janë identifikuar nga monitorimi ajror, prej të cilave: 7 % nga monitorimi ajror me helikopter dhe 28 % nga monitorimi ajror i Guardia di Financës.

Objektivi vjetor ka qenë ulja me 20% e numrit të bimëve narkotike të kultivuara dhe të asgjësuarra (referencë viti 2017). Numri i bimëve rezultoi 68% më i lartë se objektivi vjetor.

Identifikimi i sipërfaqeve me bimë narkotike të kultivuara gjatë 2019 (sipas mënyrës së identifikimit në %)



IX. BURIME TË INFORMACIONIT

Gjatë vitit 2019 janë hedhur hapa të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të veprimtarisë informative dhe inteligjente të Policisë Kriminale përmes modernizimit të saj me kapacitete të teknologjisë së informacionit. Aplikimi nga Policia Kriminale i hetimeve proaktive ka zhvilluar bashkëpunimin efikas mes strukturave dhe agjencive relevante brenda vendit dhe atyre homologe partnere, për mbledhjen, përpunimin dhe analizën e informacionit kriminal.

Është realizuar indikator i për rritjen e numrit të informacioneve të marra nga burimi “Informator” në masën 4% (reference viti 2018) në masën 113.2%, ndërsa indikator i rritjes së numrit të informatorëve (referencë viti 2018) është realizuar në masën 1 %.

51753 informacione janë marrë nga të gjitha burimet e informacionit është.

Indikator i për vitin - Rritje e numrit të informacioneve të marra nga të gjitha burimet e informacionit në masën 4% është realizuar në masën 106.2%.

Janë hartuar 1243 raporte analitike, 10 raporte më pak se në vitin 2018.

X. TASK FORCAVE SPECIALE QENDRORE DHE VENDORE

Gjatë vitit analizues janë goditur **8 grupe** të strukturuar kriminale. Objektivi vjetor ka qenë goditja e jo më pak se 3 grupeve të strukturuar kriminale për të cilat po zhvillohen hetime intensive proaktive nga Task Forca. **Realizuar 267%**

Janë referuar 4 hetime pasurore. Objektivi vjetor ka qenë referimi i jo më pak se 5 hetimeve pasurore për anëtarët e grupeve kriminale në ndjekje nga TFSQ dhe TFSV Tiranë, Durrës, Vlorë, Korçë dhe Elbasan. Realizuar 80%.

Numri i çështjeve penale të pezulluara të kryera nga anëtarët e grupeve kriminale; në ndjekje nga TFSQ dhe TFSV, është 5. Objektivi vjetor ka qenë zbardhja e jo më pak se 5 çështjeve të vjetra penale të pezulluara të kryera nga anëtarët e grupeve kriminale në ndjekje nga TFSQ dhe TFSV Tiranë dhe Elbasan dhe është realizuar 100%.

XI. RENDI E SIGURIA PUBLIKE

Numri i telefonatave nga publiku ka qenë gjithsej **562.677**, nga të cilat 550.725 janë të sakta, ose 98% e tyre, janë marrë 256.324 telefonata më shumë se viti 2018, ose **54% më shumë** se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Indikatori për vitin: 7%, **Realizuar** në masën rreth **8 herë më shumë** se objektivi.

Në portalin “Komisariati Dixhital”, janë evidentuar **45.137 njoftime** nga publiku ose 17% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Indikatori për vitin: 4%, Realizuar në masën 4.1 herë më shumë.

Aksidente rrugore me pasoja të rënda janë evidentuar **227 raste**, ose 14 raste më shumë ose 7% më shumë se viti 2018. Indikatori për vitin: 1-1.5% e totalit të aksidenteve rrugore, është realizuar në masën 8.2 herë më shumë.

Për menaxhimin e aktiviteteve të ndryshme për sigurimin e rendit publik, janë kryer **5378 shërbime** ose 8% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Realizuar në masën 100%

XII. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Janë shkëmbyera me partnerët ndërkombëtarë në total **31591 informacione**, prej të cilave:

- Nga Interpol: **18500** informacione,
 - Nga Europol + TFAF: **8645** informacione,
 - Nga Oficerët e Kontaktit: **4446** informacione.
- Indikatori për vitin ishte rritja me +5%: Aktualisht **rritja** u arrit me **1814** informacione ose **+6%** më shumë se viti 2018.

Janë koordinuar në total nga Interpol, Europol+TFAF dhe Oficerët e Kontaktit **65** operacione policore, duke shënuar një rritje me **32** operacione ose **+96.9%** krahasuar me vitin 2018. (Indikatori +5%)

Janë arrestuar për qëllime ekstradimi drejt vendit tonë dhe drejt vendeve të tjera gjithsej **272** persona në kërkim ndërkombëtar. Në krahasim me vitin e kaluar, janë arrestuar 17 persona më shumë, ose **+6.6%**.

Janë ekstraduar drejt vendit tonë ose vendeve të tjera **190** persona. Në krahasim me vitin e kaluar, janë ekstraduar **43** persona më shumë, ose **+29.2%**.

XIII. MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT DHE MIGRACIONIT

Gjatë 2019 arritje u shënuan në drejtim të kontrollit më të mirë të kufirit. U menaxhuan me kujdes flukset në rritje si të shtetasve ashtu dhe mallrave.

Ndër aktivitete kryesore të kryera:

Janë përpunuar në Hyrje - Dalje shtetas shqiptarë e të huaj në Pikat e Kalimi e Kufitar në total **24 286 082** shtetas, ose **1 607 045** shtetas më shumë, e shprehur në përqindje, **7 %** se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, si dhe **7 001 293** automjete, ose **541 418** mjete më shumë, e shprehur në përqindje, **8.4 %** më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Janë raportuar **388** raste dhe sekuestruar **554** dokumente udhëtimi (pasaporta – 101, vula – 59, ID – 225, viza – 7, leje qëndrimi – 24, të tjera – 138) dhe 650 viza pullë të paplotësuara.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka një rritje me gjithsej **68** raste e shprehur në përqindje me 21% më shumë.

Janë kapur **526** shtetas në kërkim (nga të cilët **331** në kërkim kombëtar, **112** në kërkim ndërkombëtar dhe **59** në kërkim për llogari të shtetit të Kosovës) ose **40** më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Janë sekuestruar në **52** raste lëndë narkotike me një sasi në total prej **3 554** kg, nga të cilat të dyshuara të llojit kanabis sativa **3 343** kg 94 gr, të llojit kokainë **129.4** kg dhe të llojit heroinë **23kg 244 gr**. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, një **ulje** me gjithsej **35** raste ose **40 %** me më pak, me gjithsej **1 976 kg** më pak se viti kaluar ose **35%** më pak .

Janë kryer në **10** raste operacione detare në bashkëpunim me **Guardia di Finanza**, gjatë të cilave është sekuestruar në total një sasi prej **4131** kg lëndë narkotike cannabis sativa, nga këto, 3127,5 kg në Shqipëri, 1003,95 kg në Itali, 1 litër vaj hashashi dhe 56.175 kg çokollatë hashashi në Shqipëri, si dhe 10,35 kg vaj hashashi në Itali. Janë sekuestruar mjete lundruese (8 gomone) dhe 4 (katër) katamaran, 3 automjete të tipave të ndryshëm, 2 karrela, 1 traktor.

Rezultojnë të “Refuzuar në Dalje”, për shkak se nuk plotësojnë kushtet për të udhëtuar drejt vendeve të zonës Schengen **14 223** shtetas shqiptarë, nga të cilët (**691** të mitur dhe **13 532** të rritur) ose **6 027** më pak si se e njëjta periudhë e vitit të kaluar shprehur në përqindje **30 %** më pak. Kjo rënie vjen për shkak të ndërgjegjësimit të shtetasve shqiptarë për të plotësuar të gjitha kushtet për të udhëtuar për në zonën Schengen pa viza.

Janë kthyer INAD **11 949** shtetas shqiptar ose **2 278** më pak, e shprehur në përqindje **16%** më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar si dhe janë deportuar **12 404** shtetas si rezultat e shkeljes së rregullave të qëndrimit në zonën Schengen. ose **3 071** më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, e shprehur në përqindje **20%** më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Janë evidentuar **1899** vepra në fushën e krimit ndërkufitar që rezulton me **189** raste më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar ku u evidentuan **1700** raste dhe shprehur në përqindje **11 %** më shumë.

Janë kapur **1 357** shtetas shqiptarë në tentativë për kalim të paligjshëm të kufirit ose **800** shtetas më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Kjo rënie e numrit të shtetasve shqiptarë të kapur në tentativë për kalim të paligjshëm të kufirit për shkak të rritjes së numrit të patrullave në kufirin e gjelbër dhe bashkëpunimit të ngushtë me shërbimet e FRONTEX të dislokuara në kufirin me Greqinë që nga muaji Maj 2019.

Gjatë periudhës së operacionit me Frontex që ka filluar me 22 maj 2019, në zonën operacionale Korçë - Gjirokastrë - Sarandë, që janë edhe pikat e hyrjes së imigrantëve të parregullt, **janë kapur dhe përpunuar 7087 imigrantë** të parregullt, ose 77.8% e imigrantëve të parregullt të kapur në vendin tonë gjatë kësaj periudhë, kur janë kapur 9111 **imigrantë të parregullt**.

Numri i imigrantëve të parregullt të kapur në kuadër të operacionit, 7087, është **6 herë më i madh** se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, kur janë kapur vetëm 1180 imigrantë të parregullt. Pra, ndërsa numri i imigrantëve të parregullt të kapur në vendin tonë, gjatë periudhës së operacionit është rritur 93%, numri i atyre të kapur në zonën e operacionit është rritur 6 herë.

Në Kapshticë/Korçë, numri i imigrantëve të parregullt të kapur gjatë periudhës së operacionit është 5827, ose rreth 8 herë më i madh se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, kur janë kapur 730 imigrantë të parregullt. Ndërsa në Kakavijë, Gjirokastrë, numri i imigrantëve të parregullt të

kapur është 1260 ose 2.8 herë me i madh se i atyre të kapur gjatë të njëjtës periudhë të vitit të kaluar, kur janë kapur 450 imigrantë të parregullt.

Janë kryer 1014 patrullime të përbashkëta me vendet fqinje nga të cilat **633** në kufirin tokësor dhe **300** patrullime të përbashkëta në kufirin detar me Guardia di Finanza që krahasuar me të njëjtën periudhë me vitin e kaluar janë kryer janë realizuar **48** patrullime më shumë ose 5% më shumë.

Janë kapur 11 890 shtetas të huaj imigrantë të parregullt. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar një rritje me gjithsej **4 997** shtetas të huaj imigrantë të parregullt më shumë/ ose **72 %** me shumë/më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Janë pranuar dhe vlerësuar **8 250** aplikime **për leje qëndrimi** të shtetasve të huaj ne Republikën e Shqipërisë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar vihet re ulje me **840** shtetas ose e shprehur në përqindje **9 %** më pak se një vit më parë. Ulja e aplikimeve për leje qëndrimi i korrespondon mos regjistrimit në FER për shkaqe administrative të rreth 2000 shtetasve iranian të grupimit MEK.

Janë vlerësuar 3525 aplikime për vizë hyrje në Shqipëri dhe krahasuar me vitin e kaluar rezultojnë një rritje me **506** aplikime më shumë se gjatë vitit **2018**, ku u vlerësuan gjithsej **3019** aplikime. Rezultojnë se gjatë këtij viti janë rritur me 17% numri i aplikimeve për vizë hyrje në vendin tonë. Kjo rritje e aplikimeve vjen për shkak të rritjes së interesit për turizëm në vendin tonë të shtetasve për të cilët kërkohet vizë për të hyrë në Shqipëri.

XIV. MENAXHIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Aktivitetet kryesore të kryera në fushën e trajnimeve evidentohen:

- Janë kryer **417 trajnime** të specializuara dhe të avancuara ku kanë marr pjesë **5691** punonjës policie. Programi vjetor i trajnimeve realizuar në masën **75 %**. (Mos realizimi ka ardhur si rezultat i mungesës së ambienteve për zhvillimin e tyre në dy mujorin e fundit 2019).
- Kanë marr pjesë në trajnimet në shërbim **7252** punonjës ose **93 %** e tyre.
- Janë kryer nga donatorët **308** trajnime, ku kanë marrë pjesë **3485** punonjës policie.

Në fushën e personelit janë realizuar në total **1608** praktika për nevojat e dinamikës së personelit, nga të cilat:

- Emëruar **208** kursante që kanë përfunduar “Kolegjin e Lartë Profesional “Kolegjin e Policisë”, në Komisaritet e Policisë, në funksionin organik oficer i patrullës së përgjithshme;
- Emëruar **36** kursante që kanë përfunduar kursin e trajnimit për specialist të hetimit të krimit, të cilët janë emëruar kryesisht në strukturat e hetimit të krimit ekonomik e financiar, dhe hetimit të trafikeve dhe narkotikeve në Drejtoritë Vendore të Policisë;
- Mbështetur në nenin 40/1 të Ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, është zhvilluar procedura e pranimit ne Policinë Shtetit të **38** ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura, të cilët janë trajnuar ne Akademinë e Sigurisë dhe janë emëruar në strukturën e Forcës së Posaçme Operacionale;
- Janë dhënë grada “Kryekomisar” **30** punonjësve të policisë dhe “Komisar” **155** punonjësve të policisë, pas përfundimit të procesit të konkurrimit për gradë;
- Janë emëruar nëpërmjet DAP, **7** studentë (ekselentë) në detyra të ndryshme në strukturat mbështetëse në Policinë e Shtetit;
- Janë plotësuar **224** praktika (dosje të veçanta) për familjet e punonjësve të rënë në krye të detyrës.
- Janë përgatitur **224** praktika për ndihmë financiare familjeve të punonjësve të policisë të rënë në krye të detyrës, në ditën përkujtimore të humbjes së jetës për shkak të detyrës.

Janë hetuar dhe verifikuar gjithsej 732 punonjës policie:

- Rekomanduar DVP-ve e DVKM-ve në **227 raste** (për shkelje të lehtë disiplinore) dhe janë ndëshkuar **145** punonjës policie për shkelje të lehtë disiplinore.
- Janë ndëshkuar **325** punonjës policie me masa për shkelje të rëndë disiplinore. Prej tyre:
 - o Përrjashtuar **72** punonjës policie,
 - o Ulje në një grade, **2 raste**, deri në 6 muaj
 - o Shtyrje e afatit të gradimit **240** punonjës,
 - o Largim nga puna **8 raste**.

Financat dhe logjistika:

- Fondet buxhetore brenda limitit të miratuar për Programin “Policia e Shtetit” janë **17,352,246 mijë lekë**, më shumë se viti 2018, ose **me një rritje prej 3,6 %**.
- Shpenzimet për investime në vitin 2019 janë rritur me **152,607 mijëlekë**, ose **7,5 % më shumë se vitin e kaluar**.
- Fondet buxhetore brenda limitit të miratuar për Programin “Policia e Shtetit”, janë realizuar në shumën 16,825,021 mijë lekë, nga 17,352,246 mijë lekë të planifikuara, ose **97 % e planit**.
- Sigurimi i trajtimit financiar të punonjësve të Policisë së Shtetit (përfshirë edhe orët jashtë orarit dhe orë nate **100%** dhe dietat **77.8 %**, me një detyrim të mbartur të pa likuiduar në masën 22,2% (detyrimi 37 milion lekë).
- Të ardhurat mujore neto për një punonjës policie janë në të njëjtin nivel krahasuar me vitin 2018.
- Janë furnizuar punonjësit e Policisë me objektet e uniformës në masën **35%**.
- Janë realizuar fondet e planifikuara për investime të brendshme në masën **98,8 %** të planit.
- Projektet e investimeve të parashikuara për mirëmbajtjen, përmirësimin e zgjerimin e sistemeve e pajisjeve të teknologjisë së informacionit janë realizuar në masën **100 %** të planit.
- Janë kryer punimet për rikonstruksionin apo ndërtimin e objekteve të reja për 5 projekte, në vlerën 449,383,487 lekë, kryesisht në Reparti Special Rëna, Ndërtimi Objekteve të Drejtorisë dhe Komisarariatit të Policisë Shkodër, Ndërtimi i Bllokut të Sigurisë DVP Tiranë, Ndërtimi Objektit të administratës në PKK Hani Hotit, Ndërtimi i Data Center për Policinë e Shtetit. (3-4 objekte kryesore).
- Janë realizuar punimet për mirëmbajtjen, zgjerimin apo ndërtimin e sistemeve të transmetimit të informacionit për Datacom, Memex, salla serverash, fibër optike etj, me vlerë 21,484 milion lekë.
- Janë prokuruar ose realizuar fondet për blerjen e pajisjeve të Policisë së Rendit 150,129,960 lekë, ose 100% e planit, të Policisë Kufitare 44,074,675 lekë ose 98.7% e planit. Rinovimi i armatimit 109,819,200 lekë ose 100% e planit.
- Financimet e Huaja u planifikuan 818,868,000 lekë dhe u realizuan 569,637,920 lekë.
- Janë përfituar sponsorizime nga donatorë vendas e të huaj të shprehura në vlerë **483,761,320 lekë**.

IX. PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT KRYESORE PËR VITIN 2020

Duke u bazuar në pesë prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Rendit Publik, në prioritetet e strategjive ndërsektoriale, si dhe në prioritetet e punës së Ministrisë së Brendshme, për vitin 2020, për realizimin e të cilave janë planifikuar masa, detyra dhe aktivitete, Policia e Shtetit do të do fokusohet në këto objektiva kryesore:

Prioritet 1: Përforcimi i zbatimit të ligjit për ngritjen e nivelit të sigurisë.

Për këtë prioritet do të realizohen objektivat si më poshtë:

- a. Përmirësimi i legjislacionit dhe riorganizimi i strukturave qendrore dhe vendore në funksion të thellimit të luftës kundër krimit dhe reformës në sistemin e drejtësisë.
- b. Zhvillimi i filozofisë së policimit në komunitet në përshtatje me faktorët e mjedisit, me synim forcimin e besimit të komunitetit tek policia.
- c. Rritja e numrit, cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimeve që i ofrojmë publikut, nëpërmjet ofrimit të tyre on-line.
- d. Rritja e nivelit të sigurisë në shkolla, reduktimi i kërkesës për drogë, veçanërisht i pranisë dhe aksesit ndaj drogave pranë institucioneve arsimore.
- e. Rritja e forcës parandaluese dhe ndëshkuese kundër kriminalitetit, në mënyrë të veçantë kundër krimeve të rënda dhe krimeve në familje.
- f. Rritja e sigurisë rrugore, nëpërmjet parandalimit dhe reduktimit të aksidenteve rrugore me pasoja të rënda dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit të policisë rrugore.

Prioritet 2: Thellimi i luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit, duke synuar në goditjen e grupeve e rrjeteve kriminale dhe sekuestrimin e pasurisë së tyre.

Për këtë prioritet do të realizohen objektivat si më poshtë:

- a. Përgatitja e gjithë infrastrukturës ligjore e nënligjore për goditjen e veprimtarisë së krimit të organizuar dhe grupeve kriminale.
- b. Riorganizimi i strukturave të policisë kriminale në funksion të zbatimit të legjislacionit të ri për goditjen e grupeve e rrjeteve kriminale.
- c. Sigurimi i aksesit në bazat e të dhënave publike kombëtare në zbatim të legjislacionit përkatës dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- d. Udhëheqja e veprimtarisë së policimit nga inteligjenca, duke synuar në rritjen e hetimeve proaktive, sidomos për veprat penale të korrupsionit dhe pastrimit të parave.
- e. Intensifikimi i luftës dhe rritja e efektivitetit e treguesve të luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe pastrimit të parave.
- f. Intensifikimi i punës për goditjen e rrjeteve kriminale dhe individëve të përfshirë në aktivitetet kriminale të trafikeve të paligjshme.
- g. Vazhdimi i bashkëpunimit me strukturat partnere në funksion të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe akteve terroriste, me qëllim mbajtjen e kërcënimit në nivelin "I ulët".
- h. Krijimi i sektorit të ekzaminimeve audio e video si dhe vazhdimi i procesit të akreditimit të Institutit të Policisë Shkencore;
- i. Parandalimi dhe goditja e veprimtarisë kriminale e kultivimit të bimëve narkotike.

Prioritet 3: Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar.

Për këtë prioritet do të realizohen objektivat si më poshtë:

- a. Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore e nënligjore për përmirësimin e bashkëpunimit Prokurori – Polici.
- b. Forcimi i bashkëpunimi me institucionet, agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe me organet e qeverisjes vendore.
- c. Ndjekja e ndryshimeve ligjore e nënligjore për përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe plotësimin e organikës me personel të përshtatshëm.
- d. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve, kryerjes së operacioneve të përbashkëta, si dhe hartimit, nënshkrimit e zbatimit të marrëveshjeve të reja.
- e. Plotësimi dhe ndjekja e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit të Shqipërisë në BE.

Prioritet 4: Menaxhimi i integruar i kufirit dhe i migracionit.

Për këtë prioritet do të realizohen objektivat si më poshtë:

- a. Krijimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm dhe të harmonizuar me standardet e vendeve të BE-së dhe Kodin Schengen.
- b. Rritja e forcës zbuluese në luftën kundër krimit ndërkufitar.
- c. Rritja e standardeve për kontrollin e të huajve dhe parandalimin e migracionit të paligjshëm.
- d. Rritja e standardeve për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve, nëpërmjet standardizimit të pikave të kalimit kufitar sipas standardeve të vendeve të BE-së dhe Kodit Schengen.
- e. Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për pikat e përbashkëta të kalimit kufitar me vendet fqinje.

Prioritet 5: Zhvillimi dhe përafrimi i standardeve të organizatës së policisë me ato të vendeve të BE-së.

Për këtë prioritet do të realizohen objektivat si më poshtë:

- a. Përsosja e sistemit arsimor në Akademinë e Sigurisë për t’ju përgjigjur me efektivitet nevojave të strukturave në fushën e sigurisë.
- b. Përfundimi i fazës së parë të hartimit të programeve dhe kurrikulave, për të gjitha institucionet ligjzbatuese, në përmbushje të Programit të Fishës së Binjakëzimit të Akademisë së Sigurisë me Akademitë e Finlandës dhe të Estonisë.
- c. Përfundimi i ndërtimit të objekteve në DVP Shkodër, të Bllokut të Sigurisë në DVP Tiranë, të objektit për Institutin e Policisë Shkencore dhe administrimi i plotë i projektit “Blerje automjetesh”.
- d. Zgjerimi i sistemit të numrit të unifikuar 112, si dhe implementimi i PISCES dhe integrimi me TIMS.
- e. Përmirësimi në vazhdimësi i kapaciteteve të burimeve njerëzore, nëpërmjet trajnimeve të specializuara dhe të vazhdueshme të punonjësve të policisë.
- f. Përmirësimi i kushteve të punës dhe teknologjisë për punonjësit e policisë.
- g. Përfundimi i Projektit për vlerësimin e performancës së Policisë së Shtetit, duke hartuar për këtë qëllim edhe një analizë risku profesional.
- h. Përmirësimi i menaxhimit të brendshëm, nëpërmjet planifikimit të masave dhe aktiviteteve për rritjen e integritetit në Policinë e Shtetit.
- i. Bashkëpunimi me partneret ndërkombëtar për monitorimin dhe rishikimin e politikës gjinore, si dhe për platformën antikorrupsion e mbikëqyrjen e brendshme të Policisë së Shtetit.

- j. Standardizimi i statistikave të kriminalitetit sipas Sistemit Internacional Classification of Crimes for Statistical Purposes (ICCS), si dhe përfundimi e modulit të statistikave në Projektin e avancuar të Sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes.
- k. Fillimi i punës për zbatimin e projektit për ndërtimin e godinës së Institutit të Policisë Shkencore.
- l. Zhvillimi dhe përsosja e policisë nëpërmjet kryerjes së studimeve, hartimit dhe zbatimit të projekteve, planeve afatgjata si dhe modernizimit të sistemeve e pajisjeve.